

VENDIM
Nr.709, datë 25.8.2010

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat në varësi të saj për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, sipas problematikës dhe shkëmbimin e informacionit në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit, që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;

c) shkëmbimin e informacionit për subjektet që punojnë në mjedise pune që kanë rrezikshmëri të lartë për sigurinë dhe shëndetin në punë;

ç) shkëmbimin e të dhënave për aksidentet dhe sëmundjet profesionale, që janë kompetencë e Ministrisë së Mbrojtjes (në bazë të nenit 42 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”).

2. Për institucionet ku, sipas ligjit, siguria dhe shëndeti në punë është detyrë e tyre, ISHP-ja do të kontrollojë zbatimin e dispozitave që lidhen me kushtet e punës, kohëzgjatjen e punës e të pushimit, pagat, si dhe punësimin e të miturve.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha